

Tiranë, 20 Tetor 2020

Drejtuar: Znj. Vasilika Hysi, Zëvendëskryetare e Kuvendit dhe Kryetare e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut
Z. Ulsi Manja, Kryetar, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Për dijeni: Znj. Etilda Gjonaj, Ministër, Ministria e Drejtësisë
Znj. Anila Denaj, Ministër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Znj. Ogerta Manastirliu, Ministër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
Shkëlqesia e Tij Z. Luigi Soreca Ambasador i Bashkimit Evropian në Shqipëri
Shkëlqesia e Saj, Znj. Yuri Kim, Ambasadore e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri
Shkëlqesia e Tij Z. Adrian Maître, Ambasador i Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri
Shkëlqesia e Tij Z. Duncan Norman, Ambasador i Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri
Shkëlqesia e Saj Znj. Elsa Håstad, Ambasadore i Ambasadës Suedeze në Shqipëri
Shkëlqesia e Saj Znj. Guusje Korthals Altes, Ambasadore e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Shqipëri
Z. Alexandru Murzac, Kryetar në Detyrë i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri
Znj. Jutta Gützkow, Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Shqipëri
Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Z. Elvis Koçi, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
Z. Andi Kananaj, Drejtor Ekzekutiv, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
Z. Blendi Dibra, Nënkryetar i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile

Subjekti: **Kërkesë për seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile për projektligjin “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”**

Ne, një grup organizatash të shoqërisë civile, jemi bërë me dije që projekt ligji “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, prej datës 14.09.2020 është në procedurë në Parlament.

Organizatave të shoqërisë civile kanë marrë dijeni mbi këtë projekt ligj, përmes shpalljes për konsultim publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, më datë 10.06.2020.

Pavarësisht afateve të ngushta të procesit të konsultimit, reagimi i organizatave ka qenë i menjëhershëm duke kërkuar një takim konsultues përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë me sektorin dhe duke paraqitur në mënyrë konkrete komentet dhe sugjerimet për Projektligjin. Ministria e Drejtësisë i'u përgjigj pozitivisht kërkesës, takimi u zhvillua me prezencë të përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, organizatave të shoqërisë civile si dhe institucioneve shtetërore (Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile), përfaqësuesve nga Kryeministria dhe nga Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë.

Në vijim të takimit, nuk patëm më asnjë komunikim nga Ministria e Drejtësisë lidhur me komentet dhe reflektimin e tyre në Projektligj, ndërkohë që një nga kërkesat thelbësore të ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik është që organi publik ka detyrimin të paraqesë një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e rekomandimeve të bëra nga palët e interesuara, duke i njoftuar në një nga format përkatëse të parashikuara në këtë ligj (neni 19, pika 3).

Duke patur parasysh rëndësinë që ka ky projektligj në regjistrimin dhe funksionimin e sektorit, është e domosdoshme të rishikohen me vëmendje të veçantë të gjitha problematikat e ngritura nga OJF-të. Në këtë kontekst dëshirojmë të sqarojmë se procesi teknik legjislativ nuk duhet të ngarkojë palët e interesuara me detyrimin për të bërë formulime të teknikës legjislative por duhet të garantojë që çdo palë apo grup interesi të dëgjohet efektivisht për problematikat dhe sugjerimet që adreson dhe që i shërben përmirësimit të projektligjit dhe procesi i konsultimit të bazohet në parimet e mirëbesimit, argumentave reciproke dhe luajalitetit.

Sipas Rekomandimit të vitit 2007 (nr.14) të Komitetit të Ministrave mbi statusin ligjor të organizatave jofitimprurëse në Evropë, OJF-të duhet të konsulohen gjatë hartimit të legjislacionit parësor dhe dytësor që ndikon në statusin, financimin e tyre apo në sferën e veprimtarisë. Sigurimi i efikasitetit në procesin e konsultimit kërkon që ky proces të jetë përfshirës dhe të mundësojë pjesëmarrjen e grupeve të interesit që përfaqësojnë pikëpamje të ndryshme apo opozitare në ligjbërje. Në këtë kontekst, shprehim shqetësimin tonë se Ministria e Drejtësisë duhet t'i kishte kushtuar një vëmendje shumë të veçantë përfshirjes së OJF-ve që në fazat e para të hartimit të kësaj nisme dhe jo në procesin fundor të tij që përkoi me disa ditë para se kjo nismë të depozitohet në kuvend. Kjo cenoi efikasitetin e procesit të konsultimit duke i dhënë këtij procesi nota krejtësisht formale.

Megjithë qëllimin e mirë që kjo nismë ka, projektligji përmban një sërë dispozitash në vlerësimin tonë problematike, të paqarta ose të sfumuara sa i takon garantimit të lirisë së organizimit.

Vlerësojmë pozitivisht iniciativën për rishikimin e Ligjit për Regjistrimin e OJFve, për futjen e një procedure regjistrimi më të thjeshtë dhe efçente për OJF-të dhe krijimin e regjistrimit elektronik me qëllim lehtësimin e procedurave dhe uljen e kostove të regjistrimit, ndryshimeve në regjistrim apo ç' regjistrimit të tyre, mbajtjen e të dhënave të sakta për sektorin dhe rritjen e

transparencës lidhur me funksionimin dhe veprimtarinë e OJFve. Megjithatë, ajo që bie fillimisht në sy nga relacioni shoqëruar i projektligjit është fakti që nuk përmendet marrja si referencë e asnjë modeli apo modeleve ligjesh të ngjashme të vendeve të Bashkimit Evropian në hartimin e tij.

Në projektligj përmenden rekomandimet e MONEYVAL i cili për shkak të specifikave dhe fushës që mbulon ka evidentuar disa çështje që kanë të bëjnë me parandalimin e financimit nga terrorizmi në sektorin e OJF-ve, por në vlerësimin tonë, këto rekomandime kryesisht i referohen politikave të vendit (pra jo detyrimisht kërkohen ndryshime të natyrës legislative) dhe jo detyrimisht duhet të sjellin ndryshimin e një ligji të tërë dhe as nuk mund të përgjithësohen për çdo aspekt të regjistrimit të organizatave. Në të kundërt mund të krijojnë pengesa apo problematika dhe mund të krijojnë premisa për cënimin e lirisë së organizimit kolektiv të parashikuar në nenin 46 të Kushtetutës.

Projektligji sjell disa ndryshime të cilat përbëjnë shqetësim për organizatat e shoqërisë civile, si dhe paqartësi të cilat është e nevojshme të bëhen më të qarta me qëllim funksionimin më të mirë të ligjit. Disa prej çështjeve kryesore, paraqiten si më poshtë vijon.

- Duke qenë se ky është një nga ligjet bazë për regjistrimin dhe funksionimin e OJF-ve, është shumë e rëndësishme koherenca e draftit dhe ndërveprimi i tij me legjislacionin ekzistues. Në projektligj, në asnjë rast nuk shprehet specifikisht baza ligjore të cilës i referohet si për regjistrimin dhe për ç' regjistrimin. Po ashtu është e nevojshme shmangia e dispozitave që krijojnë një konflikt brenda draftit apo midis draftit dhe legjislacionit ekzistues.

- Projektligji nuk merr në konsideratë disa çështje që rregullohen nga Ligji bazë që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, të cilat ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut (Ligji nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”).

Me hyrjen në fuqi të këtij projektligji, është e paqartë se si do të adresohen në të ardhmen këto çështje (Për shembull: Si veprohet në rastin e regjistrimit në vend të OJF-ve ndërkombëtare që do të kenë një aktivitet për një kohë të përcaktuar dhe që sipas Ligjit 8788 duhet të marrin një leje të veçantë në Ministrinë e linjës. Po në rastet e regjistrimit të projekteve të Ndhmës së Huaj, si veprohet?).

- Ligji parashikon që “Sporteli elektronik”, portali elektronik i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, do të jetë i aksesueshëm nëpërmjet portalit e-albania, ku mundësohet ofrimi i shërbimit për publikun në distancë, duke komunikuar drejtpërdrejt me sistemin qendror për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, nëpërmjet mjeteve elektronike. Aktualisht, për mënyrën se si funksionon platforma, aksesin që të jep për marrjen e të dhënave dhe veprimeve që mund të kryhen, është e paqartë se si ajo mund të shërbejë për qëllimin që parashikon projekt ligji.

Është shqetësues fakti që përveç aktivitetit individual si njësi ekonomike të çdo OJF-je të regjistruar si depozitimi i vendimeve apo kërkesat në emër të institucionit, sipas projektligjit, edhe regjistrimi i OJF-ve duhet të arrihet plotësisht përmes e-albania, çka përbën dhe risinë e projektligjit. Se si do të realizohet kjo, mbetet shumë e paqartë sepse nuk ka asnjë funksion në portal që të krijojë këtë mundësi për këto veprime, aq më tepër pa patur llogari në platformë.

- Një nga paqartësitë kryesore në projekt ligj lidhet me regjistrimin dhe kompetencat e autoriteteve. Neni 49, pika 2, përcakton që administrata tatimore brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, i jep Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjitha të dhënat, që ajo disponon për subjektet e regjistruara pranë tyre. Është e paqartë për çfarë të dhënash bëhet fjalë. Nënkupton kjo një transferim total të përgjegjësisë së mbajtjes së rekordeve vetëm nga gjykata? Është e paqartë se çfarë ndodh me NUIS të organizatave që janë të pajisura me një të tillë tashmë. I paqartë po ashtu është dhe afati që ka gjykata që ti pajisë OJF-të ekzistuese me çertifikatën e re. Është e paqartë çfarë detyrimi i lind kjo OJF-ve ekzistuese lidhur me tatim taksat, sigurimet shoqërore në përditësimin e informacionit me ta.

- Është e nevojshme që regjimi tranzitor të rishihet me kujdes sidomos për OJF-të ekzistuese qofshin ato aktive apo pasive. Është e paqartë se si do të mundet Gjykata të përditësojë të dhënat me njoftim paraprak, ndërkohë kur ajo nuk disponon adresa kontakti të OJF-ve, mbi të gjitha për një pjesë të mirë të tyre që s'janë të regjistruara as në tatim taksa. Kjo është një çështje e rëndësishme që duhet menduar, sidomos kur ligji parashikon penalitete siç është ç' regjistrimi, një shkelje e rëndë e të drejtës së organizimit.

Më tej, Neni 49, pika 5, parashikon që OJF-të që nuk janë të regjistruara në administratën tatimore dhe nuk kërkojnë regjistrim atje 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ç' regjistrohen nga regjistri i OJF-ve. Duket sikur regjistrimi në organet tatimore është një parakusht për marrjen e autoritetit juridik, e kjo ngre një pikëpyetje të madhe se kush vjen i pari – autoriteti juridik apo tatimor.

- Një çështje tjetër shumë sensitive për sektorin është dhe supozimi që parashikohet edhe në këtë projekt ligj që në momentin që OJF-të regjistrohen pavarësisht nga lloji dhe fusha e veprimit, kanë automatikisht personel të paguar. Kjo nuk është aspak e vërtetë dhe është një nga çështjet që sektori e ka ngritur vazhdimisht në të gjitha raportet dhe diskutimet, por që fatkeqësisht rivjen e theksuar edhe në këtë projekt ligj.

-Lidhur me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit, nga karakteristikat që ka ky numër unik dhe funksionet e tij duket që bëhet fjalë për NUIS. Nëse po, kjo është problematike për gjithë arsyet sesi është organizuar dhe funksionon sistemi tatimor në vend. Për më tej është e paqartë se si do funksionojë diçka e tillë. Më tej, në nenin 36, përcaktohet detyrimi i OJF-ve të shënojnë numrin unik të identifikimit të organizatës në çdo korrespondencë të tyre. Është e paqartë për çfarë korrespondencash bëhet fjalë dhe midis kujt. Edhe atë midis organizatave, donatorëve dhe

jo vetëm për arsye zyrtare me institucionet? Është e nevojshme të qartësohet, gjithsesi, nëse është ky rasti, është një kërkesë e ekzagjeruar.

- Lidhur me detyrimin për regjistrim që parashikon ligji për OJF-të, referuar standarteve të vendosura në opinionet e Komisionit të Venecias, organizatat jofitimprurëse (në të gjitha format e tyre) nuk mund të detyrohen të regjistrohen për efekt të ekzistencës apo ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Në paragrafin nr.78 të udhëzuesit të përbashkët të Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR thuhet se personaliteti ligjor nuk duhet të jetë parakusht për themelimin e një organizate dhe vendimi për të kërkuar ose jo këtë personalitet është në diskrecion të vetë organizatës.

- Në seksionin IV, regjistrimet e tjera të detyrueshme, neni 16, pika 3 e projektligjit parashikon se, organizatat jofitimprurëse duhet të regjistrojnë dhe të depozitojnë ndër të tjera, pasqyrat financiare vjetore, të mbajtura sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, emërimin e likuidatorit, si dhe të dhënat e tij të identifikimit etj. Dëshirojmë të sjellim në vëmendje opinionin e Komisionit të Venecias për Azerbajxhanin, paragrafi 94 ku ndër të tjerash thuhet se dispozitat që lejojnë ndërhyrjet e paarsyeshme në autonominë e brendshme të OJQ-ve, d.m.th. detyrimet e raportimit dhe mbikëqyrja shtetërore mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm të OJQ-ve, duhet të hiqen.

- Neni 37 parashikon se çdo e dhënë e regjistruar në regjistër nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, që mbahet nga Sekretaria e Regjistrimit në format elektronik dhe botohet në faqen e zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar udhëzuesit të përbashkët të Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR-it për lirinë e organizimit, kufizime në drejtim të publikimit të të dhënave duhet të vendosen ndaj atyre organizatave që marrin fonde publike ose që me miratim paraprak shprehin dakordësinë për të bërë publik të dhënat e parashikuara në këtë dispozitë.

Përveç kësaj, Buletini të cilit i referohet projektligji, është një dokument i panjohur, për të cilin ka mungesë informacioni.

Kompetencat e kancelarit janë të paqarta. Është problematik fakti që i janë lënë dhe kompetenca për të gjitha “regjistrimet e tjera” me përjashtim të rastit të regjistrimit të parë dhe të ç’regjistrimit. Më tej, kompetenca për vendosjen e penalteteve që i është lënë mund të përbëjë shkak për abuzim, për më tepër kur nuk citohet baza ligjore dhe sa janë kompetencat në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë veprimtarinë e gjyqësorit dhe funksionet e kancelarit.

- Referenca tek ligji për kundravajtjet administrative e bën gjobën direkt të ekzekutueshme, ndërkohë që vendimi duhet të ekzekutohet vetëm pasi të marrë formë të prerë, sepse në rast të kundërt preket liria e organizimit.

- Draft ligji nuk është shoqëruar me përlllogaritje të kostove dhe buxhetit të nevojshëm për realizimin e gjithë parashikimeve në ligj, si dhe burimet specifike të financimit lidhur me to. Duke marrë parasysh vlerën e konsiderueshme për realizimin e Regjistrimit Elektronik të OJF-ve si dhe rëndësinë që ka buxheti për krijimin dhe funksionimin e Regjistrimit dhe zbatimin në tërësi të këtij Ligji, do të ishte i nevojshëm kostimi i plotë si dhe parashikimi i burimeve të financimit. Mungesa e buxhetit ose pamjaftueshmëria e tij, do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në krijimin dhe funksionimin e Regjistrimit, duke e bërë të pazbatueshëm Ligjin. Kjo do të krijonte konfuzion mes autoriteteve përgjegjëse si dhe OJF-ve duke ndikuar negativisht dhe penguar regjistrimin dhe funksionimin e këtyre të fundit.

Këto janë vetëm disa nga shqetësimet parimore të ardhura nga vetë sektori i shoqërisë civile, pas një sërë konsultash dhe takimesh të brendshme, organizuar me organizata në të gjithë vendin, si dhe me përfaqësues të komunitetit donator dhe institucioneve ndërkombëtare të cilët i kemi bërë me dije sa më lart.

Sa më sipër, i drejtohem Kuvendit me kërkesë për të realizuar një seancë dëgjimore me një përfaqësi të grupit të organizatave, ku të kemi mundësi të parashtrijmë të gjitha problematikat e identifikuar, rezervat dhe sugjerimet tona si dhe kërkojmë të kemi mundësi për të vendosur ura komunikimi të vazhdueshme, me qëllim që të gjitha këto probleme dhe sugjerime të nënshtrohen një debati të mirëfilltë parlamentar, dhënies së argumentave reciproke dhe të bazuara në standartet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira.

Për çdo komunikim të mëtejshëm, në emër të grupit propozues pika e kontaktit për këtë çështje është Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në adresën e email info@resourcecentre.al, numër telefoni +35542254881, në adresë Rruga e Elbasanit, PARK GATE, Kati 10, Ap. 71 / 73, Tiranë, Shqipëri.

Duke Ju falenderuar paraprakisht për marrjen në konsideratë të kërkesës sonë,

Me respekt,

(sipas rendit alfabetik)

Co-Plan, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

Forumi Civil Selenicë

Instituti Për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Instituti për Kontratën Shoqërore

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lëvizja Evropiane në Shqipëri

Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Organizata “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”

Organizata “Udhëtim i Lirë”

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Qendra “Epoka E Re”

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Qendra Burimore e Mjedisit, Shqipëri (REC Albania)

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin

Roma Active Albania

Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri - Birn Albania

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)

Shoqata “Përtej Barrierave”

Shoqata “Ndihmoni Jetën”